

5

UDHËZUESI I MËSIMDHËNËSIT PËR
**ZHVILLIMI
PERSONAL**
PËR KLASËN E 5-TË



Ky botim është zhvilluar si pjesë e projekteve zvicerane të Departamentit për projektet ndërkombëtare për edukimin, në Universitetin e Përgatitjes së Mësimdhënësve në Cyrih, i cili edhe koordinoi botimin, hartimin dhe redaktimin e të gjitha materialeve.

Pjesë të këtij manuali të sapo zhvilluar janë frymëzuar nga materialet mësimore të projekteve ndërkombëtare të departamentit IPE të Universitetit e Përgatitjes së Mësimdhënësve në Cyrih (PUNB, FYTY, CORE, Demokracia e gjallë). Ato mund të gjenden në ipe-textbooks.phzh.ch.

Ky botim u mbështet nga Fondi i Komunitetit të Kantonit të Cyrihut (Zvicër).



Kanton Zürich
Gemeinnütziger Fonds

Autorët

Corinna Borer
Wiltrud Weidinger

Përkthyes

Qendra për Arsim e Kosovës

Editor

Qendra për Arsim e Kosovës

Dizajni grafik

Nadine Hugi

Botuar në 2021

Universiteti i Përgatitjes së Mësimdhënësve në Cyrih,
Projektet Ndërkombëtare në Edukim (IPE)

phzh.ch/ipe
ipe-textbooks.phzh.ch



Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë ose mjet, elektronik ose mekanik, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo ruajtjen e informacioneve, pa leje paraprake të shkruar nga Fondi i Komunitetit të Kantonit Cyrih – Departamenti për Financat, i cili është pronari i vetëm i këtij botimi. Kjo vlen në të gjithë botën.

UDHËZUESI I MËSIMDHËNËSIT PËR ZHVILLIMI PERSONAL PËR KLASËN E 5-TË

Udhëzimet e përgjithshme pedagogjike	2
Çka janë shkathtësitë për jetë në zhvillimin personal?	2
Shkathtësitë për zhvillim personal si pjesë përbërëse e shkollës dhe jetës	2
Si organizohen shkathtësitë e ndryshme?	4
Si duhet t'i përdori modulet?	5
Cili është roli im si mësimitdhënës?	5
Si është i strukturuar udhëzuesi?	6
Cilat materiale shtesë mund t'i përdori?	6
Ku e regjistrojnë nxënësit punën e tyre?	6
Si vlerësohen nxënësit?	7
Si e vlerësoj mësimitdhënien time?	7
Si përfshihen prindërit në lëndën e zhvillimit personal?	7
Literatura	8
Udhëzuesi i mësimitdhënësit për zhvillimi personal për klasën e 5-të	9
Moduli 1 - Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve	15
Moduli 2 - Sigurimi i cilësisë së jetës	25
Moduli 3 - Stilet e jetës së shëndetshme	35
Moduli 4 - Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse	45
Moduli 5 - Siguria personale	55

UDHËZIMET E PËRGJITHSHME PEDADOGJIKE

«Udhëzuesi i mësimdhënësit për zhvillimi personal për klasën e 5-të» është udhëzues për mësimdhënësit të cilët ua mësojnë nxënësve të tyre shkathtësitë për jetë dhe ato të zhvillimit personal. Manuali fokusohet në mënyrat si të mësohen shkathtësitë perkatese që janë të nevojshme për zhvillimin e nxënësve të shëndetshëm në aspekt fizik dhe mendor, si dhe përkrah zhvillimin e identitetit të tyre personal. Këto shkathtësi dhe kompetenca për jetë i përfshijnë edhe shkathtësitë të cilat u nevojiten fëmijëve dhe adoleshentëve në situata të ndryshme në shkollë dhe jetë, e të cilat do ti hasin si tash, po ashtu edhe në të ardhmen, si në jetën private ashtu edhe në atë profesionale.

Cilat janë shkathtësitë për jetë në zhvillim personal?

Shkathtësitë për jetë përfshijnë kompetencat dhe shkathtësitë nga sfera të ndryshme të zhvillimit të personalitetit. Ato përfshijnë:


- **Shkathtësi kognitive** si shkathtësi për zgjidhjen e problemeve, shkathtësi të menduarit kreativ, shkathtësi të menduarit kritik dhe shkathtësi meta-kognitive;
- **Shkathtësi sociale** si shkathtësi komunikimi dhe bashkëpunimi, shkathtësi për raporte ndërpersonale dhe empati;
- **Shkathtësi të vetëdijesimit** si vetë-përgjegjësia, shkathtësi për vendim-marrje dhe shkathtësi për vetë-reflektim;
- **Shkathtësi për rregullimin emocional** kanë të bëjnë me emocionet, stresin dhe shkathtësi për zgjidhjen e konflikteve.

Shkathtësitë që janë elaboruar në këtë program për zhvillim personal e ndjekin kornizën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për përcaktimin e shkathtësive të cilat u nevojiten individëve për të qene të suksesshem gjatë jetës së tyre (2001). Është me rëndësi të theksohet se të gjitha shkathtësitë për jetë janë të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe mënyra më e mire për të perkohur zhvillimin e tyre është përmes qasjes gjithëpërfshirëse. Shkathtësitë kognitive asnjëherë nuk mund të trajnohen pa i ndërlidhur me shkathtësitë sociale dhe të vetë-njohjes, shkathtësitë për rregullimin emocional asnjëherë nuk mund të trajnohen pa i marrë parasysh edhe shkathtësitë sociale e kështu me radhë.

Shkathtësitë për zhvillim personal si pjesë përbërëse e shkollës dhe jetës

Edukimi për zhvillim personal dhe shkathtësi për jetë është i inkorporuar në të gjitha lëndët dhe gjithmonë është i ndërlidhur me përmbajtjen mësimore që është relevante për individin në stadin e tij/saj aktual të zhvillimit. Përmbajtja dhe detyrat në këtë program të zhvillimit personal synojnë grupmosha dhe klasa të ndryshme. Përgjatë kurrikulës së shkollimit të obligueshëm, mësimi i shkathtësive për jetë bëhet gjithnjë e

më kompleks, duke përcjellë tema të ngjashme çdo vit e duke u fokusuar në të njëjtat shkathtësi gjatë gjithë kohës në shkollë. Edukimi i shkathtësive për jetë është i ndërtuar në mënyrë progresive që nga moshën e re e tutje, duke filluar në pikën fillestare të hyrjes në sistemin edukativ në kopsht ose shkollë fillore për të vazhduar deri në fund të shkollimit të obligueshëm. Në vazhdim të jetës shkollore të nxënësit, shkathtësitë për zhvillim personal mësohen përmes një kurrikule spirale: ato përsëriten në çdo vit shkollor, por çdo herë në një nivel më kompleks.



Kurrikula spirale e zhvillimit personal dhe edukimit për shkathtësitë për jetë mund të përshkruhet si qasje e cila i prezanton konceptet e ndryshme kryesore për nxënësit me rritje të shkallës së kompleksitetit përgjatë viteve shkollore. Sipas paradigmes së edukatorit dhe psikologut Jerome Bruner se «çdo lëndë mund t'i mësohet çdo fëmijë në mënyrë efektive në formë të sinqertë intelektuale në secilën fazë të zhvillimit» (Bruner 1960), kurrikula spirale është parim themelor pedagogjik për këtë program. Informatat, temat dhe detyrat u prezantohen fëmijëve në moshë të re dhe ri-prezantohen, përforcohen dhe ndërtohet mbi to në vazhdimësi. Përmes kësaj metode të përshtatme të të nxënësit nuk zhvillohet vetëm aftësia për shkathtësi të ndryshme për jetë, por edhe kuptimi dhe rëndësia e asaj që mësohet bëhet pjesë përbërëse e programit. Kjo kurrikulë spirale përfshin ide, parime dhe vlera të cilat janë të rëndësishme për nxënësit përderisa ata rriten, si edhe për tërë shoqërinë si tërësi. Andaj, ky program e ndjek edhe qasjen dhe paradigmen e të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Si organizohen shkathtësitë e ndryshme?


Në këtë program për zhvillim personal, shkathtësitë për jetë mësohen në një sekuencë prej pesë modulesh të cilat i përfshijnë konceptet kryesore. Ato janë:

**Moduli 1**

«Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve» thekson vetë-njohjen dhe vetëbesimin, hulumtimin dhe vetë-vlerësimin e burimeve personale, familjen si vlerë: përgjegjësitë, rolet gjinore, stereotipat, komunikimin me vendosmëri, pa konflikt dhe pa dhunë, vullnetarizmin, etj.

**Moduli 2**

«Sigurimi i cilësisë së jetës» me theks në integritet, menaxhim efikas të burimeve, përgjegjësi për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhim të mirë të vetes, etj.

**Moduli 3**

«Stilet e jetës së shëndetshme» udhëzojnë nxënësit për çështjet që lidhen me shëndetin fizik dhe emocional, ushqimin e shëndetshëm, si kundërpërgjigje e veseve si droga, alkooli, duhanpirja, ndikimet gjinore, etj.

**Moduli 4**

«Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse» me theks në të kuptuarit e profesioneve nga perspektiva e tregut të punës, planifikimit të karrierës dhe vendimmarrjes për karrierë, ndërmarrësia si opsion i karrierës, etj.

**Moduli 5**

«Siguria personale» i pajis nxënësit me qëndrim të orientuar kah sjellja që mundëson sigurinë personale dhe të të tjerëve.

Sipas kurrikulës spirale, secili udhëzues në këtë seri e ndjek strukturën e njëjtë të moduleve dhe koncepteve kryesore. Detyrat janë të ndara përgjatë një viti shkollor, me katër detyra për modul. Andaj, secili udhëzues përbëhet nga gjithsej 20 detyra. Sidoqoftë, temat dhe detyrat për nxënës shpesh herë ndërliken; detyra për stilin e shëndetshëm të jetës do të prekë në sigurimin e cilësisë së jetës dhe artin e vetë-njohjes; detyra e përqendruar në opsionet e karrierës për fëmijë më të rritur do të prekë edhe vetë-njohjen dhe sigurimin e cilësisë së jetës e kështu me radhë. Prandaj, edhe pse detyrat janë të organizuara në pesë module, ato nuk mund të shihen si plotësisht të ndara.

Qasja modulare insiston në intervenim edukativ të karakterizuar me integrim të njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve specifike për zhvillimin e kompetencave. Qasja integruese zbatohet në secilin modul, duke përfutur nga gjërat që arrihen në lëndët tjera shkollore, apo në mjedisin shoqëror dhe familjar të nxënësit. Në këtë mënyrë, kursi i zhvillimit personal përqendrohet në zhvillimin e kompetencave me fokus të veçantë në vlerat, qëndrimet dhe predispozitat.

Si duhet t'i përdori modulet?

Modulet dhe detyrat e ndryshme në këtë udhëzues janë të paraqitura në mënyrë kronologjike. Ne ju sugjerojmë t'i përmbaheni këtij rendi pasi që i ndërton shkathtësitë e ndryshme për jetë në mënyrë të shkallëzuar përmes koncepteve kryesore dhe përmes një procesi të dizajnuar me kujdes. Metodatat për mësimdhënie dhe mësimnxënie që janë përdorur në këtë program përfshijnë metodën e të nxënës të bazuar në detyra dhe të nxënës bashkëpunues. Të dyja janë të rrënjësura në qëndrimin e të nxënës kognitiv-konstruktivist ku nxënës i ndërtojnë njohuritë e tyre përmes vetë-angazhimit në detyrat e dhëna në nivel individual, i shkëmbejnë mendimet e tyre në dialog me një partner apo në grupe të vogla dhe pastaj i ndajnë rezultatet me tërë klasën. Ky princip i «mendo-çifto-ndaj» mund të gjendet në shumë detyra dhe si i tillë kontribuon në zhvillimin e shkathtësive shoqërore dhe bashkëpunuese. Vetë-reflektimi i proceseve të të nxënës dhe reflektimi së bashku me të tjerët është pjesë e rëndësishme e zhvillimit personal dhe mund të gjendet në detyra të ndryshme.

Cili është roli im si mësimdhënës?

Në këtë program, roli i mësimdhënës është ta iniciojë dhe ta udhëheqë procesin e të nxënës, t'i udhëzojë dhe tu gjendet përkrah nxënësve gjatë të nxënës të tyre dhe tu ndihmojë t'i tejkalojnë vështirësitë. Mësimdhënës duhet të jenë të vetëdijshëm se kjo mund të nënkuptojë ndryshim në rolin e tyre drejt rolit të trajnerit dhe fasilitatorit. Ky ndryshim i referohet edhe vlerësimit të proceseve të të nxënës dhe evaluimit të rezultateve të të nxënës. Nga nxënës kërkohet t'i gjejnë strategjitë e tyre për zgjidhjen e problemeve: duke vlerësuar në mënyrë të pavarur problemin dhe duke vlerësuar në mënyrë kritike mënyra të ndryshme të zgjidhjes së tij. Prandaj, rezultati i të nxënës për secilin nxënës shihet në mënyrë individuale. Rezultatet e zhvillimit personal nuk mund të notohen në mënyrë sumative me nota klasore. Vlerësimi i proceseve të të nxënës

duhet të bëhet në mënyrë formative, që nënkupton se mësimitdhënësit vëzhgojnë dhe vlerësojnë proceset e të nxënësve në mënyrë të vazhdueshme e jo vetëm rezultatet e tyre. Dhënia e informatës kthyesë individuale dhe personale bëhet pjesë shumë e rëndësishme e rolit të mësimitdhënësit.

Si është i strukturuar udhëzuesi?

Secili udhëzues për mësimitdhënësit për zhvillim personal është i ndërtuar në të njëjtën mënyrë. Në faqet në vijim mësimitdhënësit do të gjejnë përshkrime më të detajuara të moduleve dhe të shkathtësive për jetë, për klasat e tyre specifike. Më pas mund të gjenden përshkrimet e 20 detyrave, të ndara në pesë module. Secila detyrë është e ndërtuar në të njëjtën mënyrë: Në anën e majtë të faqes mësimitdhënësit i gjejnë qëllimet, shkathtësitë, një përshkrim të rrjedhës së planit mësimit, një kornizë kohore të përafërt, materialet dhe përgatitjet e nevojshme për atë detyrë. Disa detyra përbëhen nga një proces dy-pjesësh i mësimitdhënies-dhe-të nxënësve, sugjerime për detyra të shtëpisë dhe njësi përcjellëse. Në këtë mund të gjendet një përshkrim i detajuar hap-pas-hapi i njësisë mësimit. Në anën e djathtë janë të listuara të gjitha udhëzimet të cilat u nevojiten nxënësve, me shembuj (skica) të prezantimeve të mundshme në tabelë dhe fletë pune.

Cilat materiale shtesë mund t'i përdori?

Në këtë program janë të listuara të gjitha materialet e nevojshme për secilën detyrë. Këtu mund të përfshihen letra, lapsat, ngjyrat por edhe telefonat mobil apo kompjuterët. Për disa detyra mësimitdhënësit mund të kenë nevojë të shkarkojnë materiale shtesë nga Interneti, siç është e theksuar, varësisht nga njohuritë dhe ekspertiza e tyre paraprake. Këto raste janë të shënuara. Ju lutem keni parasysh se kjo seri e zhvillimit personal është vetëm një lloj i burimeve që mund të përdoren. Mësimitdhënësit mund të inspironen edhe nga materiale të tjera në treg të cilat fokusohen në zhvillim personal.

Ku e regjistrojnë nxënësit punën e tyre?

Ka mënyra të ndryshme përmes të cilave nxënësit mund ta regjistrojnë punën e tyre. Pasi që nuk ka libër të nxënësve, vetë mësimitdhënësit mund të vendosin për mënyrën se si dëshirojnë që nxënësit ta regjistrojnë punën e tyre.

Për shembull:

- Nxënësit punojnë në fletë pune individuale të cilat i pranojnë nga mësimitdhënësi. Të gjitha fletët mbledhen në dosje. Aktiviteti «krijojë dosjen tënde» mund të bëhet në klasat e zhvillimit personal në fillim të vitit shkollor. Materialet shtesë mund të shtohen pa problem (fotografi, etj.).
- Nxënësit mund t'i përdorin fletoret e ushtrimeve për orët e zhvillimit personal. Të gjitha skicat, shënimet, esetë, etj. regjistrohen në këto fletore. Ato janë ditarë personal. Gjërat nuk mund të humben në fletoret e ushtrimeve. Fletoret e ushtrimeve mund të dekorohen në mënyrë individuale.

- Mësimdhënësit mund të kërkojnë nga prindërit të blejnë fletore individuale të ushtrimeve për fëmijët e tyre, varësisht nga situata socio-ekonomike e tyre. Kjo gjë mund të adresohet gjatë mbledhjes së parë me prindër.

Si vlerësohen nxënësit?

Vlerësimi në lëndën e zhvillimit personal është formativ, dhe bëhet gjatë mësimdhënies dhe të nxënit në modulën e caktuar. Vlerësimet sumative bëhen pas secilit modul duke i përdorur mjetet për vlerësim. Vlerësimi sumativ bazohet në vetë-vlerësimin e nxënësve së bashku me përshkrimet për kompetencat të cilat janë zhvilluar në secilin modul. Nxënësit e identifikojnë potencialin e tyre zhvillimor dhe i përcaktojnë caqet për të ardhmen. Pas kësaj, mësimdhënësi i jep informatë kthyesë secilit nxënës në formë të kritikës konstruktive, duke u fokusuar më shumë në ndërtimin e kompetencave dhe anët e tyre të forta se sa në mangësitë e tyre. Format e vlerësimit bëhen pjesë e rëndësishme e dosjes së nxënësit.

Si e vlerësoj mësimdhënien time?

Çdo formë e mësimdhënies ka nevojë për vlerësim të rregullt dhe reflektim të praktikës së mësimdhënësit. Kjo mund të bëhet përmes vetë-vlerësimit duke i përdorur pyetjet kryesore dhe duke u fokusuar në qëllimet e përcaktuara, kompetencat e nxënësve, rezultatet e të nxënit, aktivitetin e nxënësve, etj. Reflektimi mund të bëhet edhe së bashku me ndonjë koleg (shkëmbimi me kolegë) pas vëzhgimeve të ndërsjella të njësive të zhvillimit personal. Ne rekomandojmë caktimin e pikave kyçe personale dhe komunikimin e tyre kolegut para se të bëhet vëzhgimi i orës në mënyrë që të përfitohet diçka më konkrete nga ky shkëmbim. Informata kthyesë mund të jepet në formë të kritikës konstruktive kolegjale.

Si përfshihen prindërit në lëndën e zhvillimit personal?

Orët e zhvillimit personal mbahen në shkollë. Megjithatë, për shkak të llojllojshmërisë së detyrave, nxënësit kanë detyra shtëpie të cilat mund të përfshijnë kërkimin e informatave nga prindërit apo të afërmit (p.sh. për biografitë e tyre, për rregullat, për të kaluarën, etj.). Ne rekomandojmë prezantimin e orëve të zhvillimit personal gjatë mbledhjes me prindër në fillim të vitit shkollor. Prindërit dhe familja janë pjesë e rëndësishme e zhvillimit personal të fëmijëve, identitetit, normave, vlerave dhe perspektivave të tyre të ardhshme. Mësimdhënësit duhet t'i informojnë prindërit për karakterin e programit të zhvillimit personal, tu ofrojnë një pasqyrë të moduleve të ndryshme dhe të mënyrës se si do të punojnë nxënësit në këto orë (vetëm, në çifte, në grupe, etj.). Prindërit mund të inkurajohen të marrin pjesë në procesin e të nxënit të fëmijëve të tyre dhe të fillojnë të bashkëpunojnë me shkollën në mënyrë pozitive. Për më tepër, zhvillimi personal është lëndë ku integrimi i botës së jashtme dhe komunitetit të shkollës luan rol të rëndësishëm. Në disa detyra, nxënësit do të duhet të mbledhin informata, të komunikojnë me njerëz dhe të zbulojnë fenomene të cilat janë pjesë e komunitetit. Prandaj, lënda e zhvillimit personal është e ndërlidhur me klasën,

por gjithashtu bëhet pjesë e zhvillimit të shkollës në tërësi dhe përfshirjes së të gjitha palëve me interes të komunitetit.

Literatura

- Bruner, J (1960) *The Process of Education*, Cambridge, Mass.: Harvard University Press.
- World Health Organisation (2001): *Partners in Life Skills Education*. Conclusions from a United Nations Interagency Meeting. Geneva: World Health Organisation.

UDHËZUESI I MËSIMDHËNËSIT PËR ZHVILLIMI PERSONAL PËR KLASËN E 5-TË

Ky udhëzues përbëhet nga 20 detyra të cilat janë të ndara nga katër detyra për modul. Modulet fokusohen në qëllimet dhe kompetencat në vijim:

Moduli 1:

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

Kompetenca specifike: ta shprehë identitetin e vet personal duke hulumtuar veten dhe burimet sociale në mënyrë që të ndërtojë raporte konstruktive me familjen e vet dhe të tjerët. Kjo përfshin:

- vlerësimin e nevojës për ndryshim gjatë procesit të zhvillimit personal
- njohjen e nevojave të veta dhe nevojave të të tjerëve për ta përforcuar vetë-besimin
- analizën e faktoreve të ndryshme për t'i shprehur mendimet dhe ndjenjat
- analizën e faktorëve që ndihmojnë në mbajtjen e raporteve me të tjerët dhe me familjen e vet

Temat që përfshihen në udhëzuesin për klasën e 5-të ndërlidhen së afërmi me historinë personale të nxënësit, duke u fokusuar në rrënjët e tij/saj (detyrat 1, 2), vlerat (detyra 3), zhvillimi i personalitetit brenda familjes (detyrat 1, 2), zhvillimi i shkathtësive (detyra 4).

Moduli 2:

Sigurimi i cilësisë së jetës

Kompetenca specifike: të demonstroi përgjegjësi personale në zgjedhjen e sjelljes të orientuar kah vlerësimi vetes, të tjerëve dhe mjedisit përreth për të siguruar zhvillimin e burimeve personale. Kjo përfshin:

- raportimin në lidhje me normat etike dhe sjelljen me respekt në raport me veten, kolegët, mjedisin përreth, duke siguruar atmosferë kolegjialiteti dhe rehati emocionale dhe fizike
- demonstrimin e sjelljeve të drejta, të menduara dhe me respekt drejt përcaktimit të rregullave
- vlerësimin dhe demonstrimin e sjelljeve të drejta dhe me respekt drejt vetes, kolegëve, klasës, shkollës dhe mjedisit përreth

Temat që përfshihen këtu kanë të bëjnë me raportet me miq (detyra 5), si reagojmë ndaj konflikteve dhe dallimi në mes të problemeve individuale dhe të përbashkëta (detyra 6), dhe përcaktimi i rregullave të përbashkëta për jetën shkollë dhe jetën familjare si dhe vlerësimi i kontributeve individuale në jetën familjare (detyrat 7, 8).

Moduli 3:**Stilet e jetës së shëndetshme**

Kompetenca specifike: të angazhohet në mënyrë autonome në sjellje që siguron shëndetin e vet dhe të tjerëve, duke demonstruar interes dhe iniciative. Kjo përfshin:

- përshkrimin e programit personal të aktivitetit, pushimit dhe ushqimit duke përdorur nocione specifike të normave të sanitarisë dhe higjienës për mirëmbajtjen dhe forcimin e shëndetit
- praktikimin e veprimeve që mirëmbajnë shëndetin, duke respektuar standardet e sanitarisë dhe higjienës
- pranimin e ndryshimeve në trupin e vet, duke treguar qëndrim pozitiv

Temat e përfshira në klasën e 5-të kanë të bëjnë me rëndësinë e rutinave të shëndetshme ditore (lëvizja, ushqimi, fjetja) (detyra 9), dizajnimi i një programi shëndetësor për tërë vitin (detyra 10), trupi dhe ndryshimet e tij gjatë pubertetit si edhe rëndësia e higjienës (detyra 11), dhe zgjedhjet e ndryshme dhe faktorët për të ushqyer të shëndetshëm (detyra 12).

Moduli 4:**Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse**

Kompetenca specifike: të angazhohet në mënyrë autonome në sjellje të cilat përcaktojnë drejtimin shkollor dhe/apo profesional të nxënësit, duke përfshirë njohjen dhe përfitimin nga potenciali personal dhe mundësitë e ofruara nga tregu i punës. Kjo përfshin:

- identifikimin e informatave bazike në lidhje me punën, vendet e punës dhe profesionet dhe mbledhja e tyre në dosje të ndryshme për të zhvilluar njohuri dhe të kuptuar të botës reale
- përdorimi i mundësive të ofruara nga komuniteti shkollor për të nisur iniciativa dhe për tu angazhuar në zhvillim personal
- vlerësimi i përfitimeve të planifikimit të karrierës duke u bazuar në vendime të informuara për zhvillim personal

Temat e përfshira në klasën e 5-të kanë të bëjnë me identifikimin, reflektimin dhe dhënien e arsyeve për shkathtësitë të cilat dëshiron t'i përvetësojë (detyra 13), identifikimin e shkathtësive dhe talenteve të veta dhe krijimin e perspektivave të para të karrierës (detyra 14), vlerësimi i shkathtësive dhe kompetencave të veta si individ dhe si grup (detyra 15), dhe mësimi si të prezantohen gjërat më të rëndësishme për veten (detyra 16).

Moduli 5:**Siguria personale**

Kompetenca specifike: të angazhohet në mënyrë aktive për siguri personale dhe sigurinë e të tjerëve, duke demonstruar përgjegjësi. Kjo përfshin:

- shfaqjen e interesimit për tekstet verbale dhe të shkruara në lidhje me rekomandimet për sigurinë personale dhe publike
- zbatimin e masave të rekomanduara nga institucionet e ndryshme për sigurinë personale, sigurinë në publik dhe online
- zgjidhjen e rasteve të studimit, duke shfaqur sjellje të përshtatshme

Temat e përfshira në këtë udhëzues për klasën e 5-të kanë të bëjnë me reflektimin mbi të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre (detyra 17), si të veprojmë në situata të rrezikshme (detyra 18), siguria personale në jetën e përditshme (p.sh. trafik), (detyra 19) si edhe çështjet e përgjithshme të sigurisë në shtëpi dhe shkollë (detyra 20).

MODULI 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve	15
Detyra 1 Unë – zhvillimi i personalitetit tim	16
Detyra 2 Shkathtësitë e mia dhe ku i përvetësoj	18
Detyra 3 Identiteti im në arkën e thesarit	20
Detyra 4 Anët e mia të forta – i bëj të dukshme në një lule	22

MODULI 2

Sigurimi i cilësisë së jetës	25
Detyra 5 Raportet – miqtë dhe si i trajtoj	26
Detyra 6 Reagimi ndaj problemeve të vogla dhe të mëdha në klasë	28
Detyra 7 Rëndësia e rregullave të klasës – dizajnimi i kontratës	30
Detyra 8 Rëndësia e rregullave të familjes – puna është e vlefshme	32

MODULI 3


Stilet e jetës së shëndetshme	35
Detyra 9 Shëndeti im është i rëndësishëm	36
Detyra 10 I shëndetshëm gjatë gjithë vitit	38
Detyra 11 Trupi im dhe si ndryshon ai gjatë pubertetit	40
Detyra 12 Ushqimi dhe të ushqyerit – të ushqyerit e shëndetshëm: pesë-në-ditë	42

MODULI 4

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse	45
Detyra 13 Anët e forta të cilat i dëshiroj – jam kafshë për një ditë	46
Detyra 14 Fokusohe në anët e mia të forta – plani im prej pesë hapash	48
Detyra 15 Anët e forta të grupit tonë – shkathtësitë e klasës tonë	50
Detyra 16 Përshtypjet e para janë të rëndësishme – unë e prezantoj veten	52

MODULI 5

Siguria personale	55
Detyra 17 Fëmijët kanë të drejtë të jenë të mbrojtur dhe të sigurt	56
Detyra 18 Situatat e rrezikshme – çka të bëj?	58
Detyra 19 Të jesh i sigurt në rrugë	60
Detyra 20 Të jesh i sigurt në shtëpi dhe në shkollë	62



MODULI 1

VETË-NJOHJA DHE NJOHJA E TË TJERËVE

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve thekson vetë-njohjen dhe vetëbesimin, hulumtimin dhe vetë-vlerësimin e burimeve personale, familjen si vlerë: përgjegjësitë, rolet gjinore, stereotipat, komunikimin me vendosmëri, pa konflikt dhe pa dhunë, vullnetarizmin, etj.



DETYRA 1

UNË – ZHVILLIMI I PERSONALITETIT TIM

Qëllimi

Nxënësit e vlerësojnë faktin se ndryshimi është i pashmangshëm gjatë zhvillimit të personalitetit të tyre. Ata janë në gjendje ta ndryshojnë perspektivën e tyre për të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

Rreth me karrige për diskutim plenar;
Hapësirë në mure për ekspozim;
lapsa me ngjyrë dhe letër



Moduli 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi dhe nxënësit prezantohen duke ndarë ndonjë kujtim interesant apo të këndshëm nga fëmijëria e tyre. Në fillim mendojnë (individualisht), pastaj ia tregojnë tregimin e vet partnerit (në çifte) dhe në fund e gjithë klasa bëhen bashkë dhe i ndajnë tregimet me të gjithë (nëse kanë dëshirë). Më vonë mund ta vizatojnë kujtimin e tyre të këndshëm nga fëmijëria.
2. Nga nxënësit kërkohet që për detyrë shtëpie të mendojnë për kohën kur kanë qenë të vegjël dhe të kërkojnë përgjigje nga prindërit dhe të afërmit. Ata mbledhin fotografi dhe vizatime apo sjellin objekte në shkollë për të ilustruar se si kanë qenë kur kanë qenë të vegjël.

Sekuena ②

1. Nxënësit vijnë me objektet e tyre. Ata i shkëmbejnë përgjigjet e tyre në çifte (duke zgjedhur ku do të ulen apo të qëndrojnë). Mësimdhënësi i inkurajon t'i krahasojnë përgjigjet e tyre dhe të diskutojnë se si kanë ndryshuar që atëherë.
2. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit ta formojnë një rreth me karrige. Ata i marrin objektet me vete.
3. Prezantimi: Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit ta prezantojnë veten kur kanë qenë të vegjël duke i treguar objektet e veta. Mangësia: Disa nxënës mund të mos ndihen rehat gjatë këtij aktiviteti.
4. Ora përfundon me një diskutim të shkurtër për aspektet e ndryshme të një personi të cilat mund të ndryshojnë gjatë kohës. Mësimdhënësi i mbledh idetë e nxënësve dhe i vendos ato në kategori p.sh.: pamjet, shijet, interesimet, aktivitetet, gjatësia, pesha, etj.
5. Të gjitha objektet ekspozohen në mur së bashku me emrat e shënuar.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①



Sekuena ②





DETYRA 2

SHKATHTËSITË E MIA DHE KU I PËRVETËSOJ

Qëllimi

Nxënësit e kuptojnë se i kanë mësuar shkathtësitë e tyre prej të tjerëve. Ata reflektojnë për shkathtësitë e tyre, i bëjnë të dukshme dhe i vlerësojnë ato.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

Hapësirë e mjaftueshme për të lëvizur; Detyrat në tabelë ose në fletë pune



Moduli 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e prezanton detyrën duke i vizatuar tri drunjë në tabelë. Ai/ajo e thekson se këta janë drunjë të shkathtësive.
2. Nxënësit mendojnë për tri shkathtësi. Këto shkathtësi mund të jenë kognitive, fizike, muzikore, etj. Në majë të secilit dru e shënojnë një shkathtësi. Pastaj mendojnë kur, ku dhe prej kujt e kanë mësuar atë shkathtësi. Këto i shënojnë në degë (kur), në trung (ku) dhe në rrënjë (prej kujt). Mësimdhënësi jep shembuj (në mënyrë verbale apo me shkrim në tabelë).
3. Kur përfundojnë, nxënësit lëvizin nëpër dhomë dhe i krahasojnë shkathtësitë e tyre, trungjet dhe rrënjët e tyre me të tjerëve. Ata bisedojnë së paku me dy shokë të klasës.
4. Për detyrë shtëpie, mësimdhënësi i udhëzon nxënësit ta zgjedhin një shkathtësi dhe ta pyesin prindin apo ndonjë të afërm për të. Pyetjet për intervistë janë të shënuara në tabelë apo jepen në formë të fletë punës.

Sekuena ②

1. Nxënësit vijnë me përgjigjet nga intervistat. Ata ecin përreth dhomës dhe flasin me shokët e klasës në lidhje me shkathtësitë e familjes së tyre.
2. Nxënësit gjithashtu mund të luajnë një kuiz dhe të mundohen t'i qëllojnë shkathtësitë e tyre.
3. Në fund të orës mësimore, ata ulen së bashku në grup dhe i prezantojnë shkathtësitë e tyre, rrënjët dhe vendet para njëri-tjetrit. Mësimdhënësi e drejton bisedën.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

Shkathtësitë e mia kanë rrënjë

Kur?

Ku?

Prej kujt

Shkathtësitë e familjes time

Shkathtësia ime është:

E kam mësuar nga:

- 1** *Ku e ke mësuar këtë shkathtësi?*

.....
- 2** *Çka duhet të bësh?*

.....
- 3** *A mund ta përshkruash?*

.....
- 4** *Çka të duhet për këtë shkathtësi? (Mjete, materiale, përbërës...)*

.....
- 5** *Cila është gjëja më e vështirë në lidhje me këtë shkathtësil?*

.....

Sekuena ②

Kuiz: Qëlloja çka bëj?

	Po	Jo
A është nëna, babai, motra, kushërir, etj. yt?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
A e realizon brenda?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

- A ka të bëjë shkathtësia jote me gatim, riparim, vizatim, punë me duar, etj.?
- A të nevojiten shumë materiale për të?
- A të nevojitet dru, material, ujë, ngjyrë, etj. për ta realizuar?
- A të nevojiten instrumente të rënda?

- A lëviz shumë kur e realizon atë?
- A ulesh?
- A qëndron në këmbë?
- A duhet të flasësh për ta realizuar?
- A bën shumë zhurmë?
- Etj.



DETYRA 3

IDENTITETI IM NË ARKËN E THESARIT

Qëllimi

Nxënësit reflektojnë për gjërat që janë të rëndësishme për ta. Ata i shprehin ato në mënyrë kreative dhe mësojnë si të negociojnë me të tjerët.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në grupe
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Detyrat në tabelë apo në fletë pune (shabllon i arkës së thesarit); Lapsa me ngjyrë
- ② Tavolinat e organizuara për tu ulur në grupe nga 4 persona; Kutitë, gjëra të vogla, vizatime, etj.



Moduli 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuenca ①

1. Mësimdhënësi e prezanton detyrën duke treguar shembuj të arkës së thesarit (fotografi, filma, etj.)
2. Detyra e nxënësve është të mendojnë çka do të vendosnin në arkën e tyre shumë personale të thesarit. Ata e vizatojnë arkën e tyre të thesarit në një letër (ose përdorin një shabllon). Nuk përdoret shkrimi. Me rëndësi është që nxënësit të vendosin gjëra në arkën e tyre të thesarit që janë të rëndësishme për ta dhe me të cilat identifikohen. Ata i vizatojnë thesaret e tyre në arkë.
3. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të shkojnë në shtëpi dhe të kërkojnë ndonjë kuti të cilën mund ta përdorin si arkë. Ata gjithashtu mbledhin gjëra të cilat dëshirojnë t'i vendosin në arkë dhe të gjitha i sjellin në shkollë.

Sekuenca ②

1. Nxënësit kthehen dhe i mbushin arkat e tyre të thesarit. Ata gjithashtu i dekorojnë dhe i mbushin me vizatime apo gjëra tjera të cilat mendojnë se i përfaqësojnë.
2. Nxënësit formojnë grupe prej 4 vetash. Në grupe i prezantojnë para njëri-tjetrit arkat e tyre të thesarit. Pastaj i diskutojnë ngjashmëritë dhe dallimet.
3. Nxënësit e organizojnë një ekspozitë me arkat e tyre të thesarit në klasë apo në korridor të shkollës. Ata i ftojnë klasat tjera të vijnë dhe ta vizitojnë ekspozitën e tyre.
4. Si përmbledhje përfundimtare, nxënësit ulen në rreth dhe e diskutojnë ushtrimin: Çka u ka pëlqyer? Çka ishte e vështirë? Çka i befaso i kur i shikuan arkat e thesarit të të tjerëve?



MATERIALET PËR NXËNËSIT


Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

Arka ime e thesarit



Sekuena ②





DETYRA 4

ANËT E MIA TË FORTA I BËJ TË DUKSHME NË NJË LULE

Qëllimi

Nxënësit reflektojnë për gjërat të cilat u pëlqejnë te vetja. Ata i mbledhin ato dhe hyjnë në dialog me të tjerët për ta zhvilluar vetë-perceptimin dhe perceptimin e të tjerëve.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Detyrat në tabelë apo fletë pune; Shabllon për lulen; Lapsa me ngjyrë
- ② Karriget në rreth për diskutim në grup të madh



Moduli 1

Vetë-njohja dhe njohja e të tjerëve

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e prezanton detyrën duke u treguar një shabllon të lules.
2. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit t'i shkruajnë emrat e tyre në mes të lules dhe ndonjë gjë për veten në secilën petale. Pastaj ata e ngjyrosin dhe e dekorojnë atë.
3. Në vijim mësimdhënësi u thotë nxënësve t'ia tregojnë lulen e tyre partnerit dhe të shpjegojnë çka kanë shkruar për veten. Pastaj i ndërrojnë rolet dhe e dëgjojnë shpjegimin e partnerit të tyre.
4. Pastaj e marrin lulen e partnerit, lëvizin nëpër dhomë dhe u tregojnë të tjerëve (së paku 2 personave) për partnerin e tyre.
5. Për detyrë shtëpie, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të vizatojnë petale shtesë në mes të petaleve të luleve të tyre (apo pas tyre). Në këto petale nxënësit shënojnë çka mendojnë se bëjnë mirë. Këto mund të jenë gjëra të ndryshme, si sporte, matematikë, bisedë me të tjerët, etj. Ata i sjellin sërish lulet e tyre në shkollë.

Sekuena ②


1. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit t'i shkëmbejnë lulet e tyre me «petalet e tyre të reja të anëve të forta» me një partner. Ata e marrin lulen e partnerit të tyre dhe përgatiten për prezantimin e anëve të forta të tij/saj.
2. Pastaj ata formojnë një rreth me karrige në mes të dhomës. Të gjithë i sjellin lulet e partnerëve të tyre.
3. Dy nxënës i prezantojnë partnerët e tyre para të tjerëve.
4. Mësimdhënësi e drejton diskutimin me nxënësit për dallimet në gjëra që u pëlqejnë dhe anët e tyre të forta. Anët e forta mund të jenë të ndërlikura me gjëra që janë jashtë mësimin akademik dhe që reflektojnë interesimet e tyre. Por, gjërat që u pëlqejnë dhe interesimet gjithashtu mund të jenë të pavarura nga ajo që personi mund ta bëjë mirë.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①





MODULI 2

SIGURIMI I CILËSISË SË JETËS

Sigurimi i cilësisë së jetës me theks në integritet, menaxhim efikas të burimeve, përgjegjësi për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhim të mirë të vetes, etj.



DETYRA 5

RAPORTET MIQTË DHE SI I TRAJTOJ

Qëllimi

Nxënësit reflektojnë për kuptimin dhe rëndësinë e miqësisë. Ata mbledhin gjëra të ndryshme të cilat mund t'i bëjnë së bashku me miqtë dhe për ta.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Fotografite dhe pyetjet në tabelë apo fletë pune; Fleta të zbrazëta
- ② Karriget në rreth për diskutim në grup të madh



Moduli 2

Sigurimi i cilësisë së jetës

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e prezanton detyrën duke i vizatuar dy njerëz në tabelë apo duke u treguar një fotografi të dy njerëzve që janë miq.
2. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të mendojnë për miqtë e tyre. Mësimdhënësi gjithashtu u thotë të mundohen tu përgjigjen disa pyetjeve për atë se çka e bën atë të veçantë dhe për çka kanë nevojë në miqësi.
3. Më pas, mësimdhënësi u thotë nxënësve t'i shkëmbejnë këndvështrimet e tyre në lidhje me miqësinë me një shok. Ata i ndërrojnë rolet dhe e dëgjojnë partnerin duke shpjeguar.
4. Pastaj ata mund të vendosin si dëshirojnë ta shprehin këndvështrimin e tyre mbi miqësinë. Mund të vizatojnë, të shkruajnë një poezi apo një tregim për një përvojë me mikun e tyre më të mirë, etj.
5. Për detyrë shtëpie, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që në shtëpi ta përfundojnë punimin me të cilin e kanë shprehur miqësinë.

Sekuena ②

1. Nxënësit ulen në rreth. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit ta tregojnë përshkrimin se çka nënkupton miqësia për ta dhe ta vendosin në mes të klasës. Nga nxënësit kërkohet ta prezantojnë këndvështrimin e tyre mbi miqësinë para shokëve të klasës në grup të madh.
2. Në vijim mësimdhënësi parashtron pyetjet: Çka mund të bëni me dhe për miqtë tuaj? Mblidhen idetë. Pastaj, ndryshohet perspektiva: Në çfarë mënyra mund të ju ndihmojnë miqtë tuaj? Sërish, mblidhen idetë.
3. Më pas, nga nxënësit kërkohet t'i shënojnë idetë dhe sugjerimet e tyre.

Kur të përfundojnë, i shkëmbejnë shënimet me një partner. Të dy partnerët i shënojnë me tik (✓) pikat me të cilat pajtohen dhe me iks (×) pikat me të cilat nuk pajtohen.





MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

Pyetjet





1. Kush është shok i vërtetë?
Çka është miqësia?
2. Pse është mëiqësia e rëndësishme?
3. A ka nevojë njeriu për miq?
4. Cilat karakteristika duhet t'i ketë një person për tu bërë apo për të qenë shok?

Sekuena ②

Çka mund të bëj me dhe për miqtë e mi



<p>1. Çka mund të bëni me dhe për miqtë tuaj?</p> <p>~~~~~ ~~~~~ ~~~~~</p> <p style="text-align: right; font-size: 2em;">✓</p>	<p>2. Cilat anë tua të forta u pëlqejnë?</p> <p>~~~~~ ~~~~~ ~~~~~</p> <p style="text-align: right; font-size: 2em;">✗</p>
<p>3. Në çfarë mënyra mund të të ndihmojnë?</p> <p>~~~~~ ~~~~~ ~~~~~</p> <p style="text-align: right; font-size: 2em;">✓</p>	<p>4. Cilat janë anët e tyre të forta?</p> <p>~~~~~ ~~~~~ ~~~~~</p> <p style="text-align: right; font-size: 2em;">✗</p>



DETYRA 6

REAGIMI NDAJ PROBLEMEVE TË VOGLA DHE TË MËDHA NË KLASË

Qëllimi

Nxënësit mendojnë për konfliktet dhe problemet në klasën e tyre. Ata reflektojnë për problemet e përbashkëta dhe individuale dhe mësojnë si t'i dallojnë ato.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Fotografi e dy njerëzve duke u fjalosur; Copa të vogla të letrës
- ② Karriget në rreth për diskutim në grup të madh



Moduli 2

Sigurimi i cilësisë së jetës

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e prezanton detyrën duke kërkuar nga nxënësit të japin mendime dhe ide. Si pikë fillestare mund të përdoret një fotografi e dy njerëzve që po përllahen. Pyetja udhëzuese është: Çfarë lloj problemesh mund të dalin në klasën tonë?
2. Nxënësit i shënojnë idetë e tyre në copa të letrës dhe i ngjisin ato në tabelë (apo i vendosin në dysheme). Nuk kanë nevojë t'i shënojnë emrat e tyre në letra.
3. Mësimdhënësi i prezanton të dy kategoritë: problemet e përbashkëta dhe problemet individuale. Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit t'i klasifikojnë idetë e tyre në dy kategoritë. P.sh.: shumë pak hapësirë për punë = problem individual, nuk ka mjaft libra për të gjithë = problem i përbashkët.
4. Pas klasifikimit, nxënësit kthehen në rreth. Diskutojnë së bashku me mësimdhënësin: Cilat probleme mund të zgjidhen me lehtësi dhe si mund të bëhet kjo?
5. Për detyrë shtëpie mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të mendojnë për një situatë konflikti që ka ndodhur në shkollë apo në shtëpi dhe të cilën kanë pas mundësi ta zgjidhin.

Sekuena ②

1. Nxënësit shkruajnë shkurtimisht për konfliktin dhe metodën e zgjidhjes së tij.
2. Kur të përfundojnë i vendosin fletat në mur dhe ecin përreth duke i lexuar metodat e ndryshme të zgjidhjes së konfliktit.
3. Më pas ulen në rreth. Mësimdhënësi e drejton diskutimin.
4. Nxënësit, së bashku me mësimdhënësin mundohen të gjejnë strategji të ndryshme për zgjidhjen e konflikteve. Mësimdhënësi i shënon këto strategji në një fletë letre në mes të rrethit. P.sh. qëndro i qetë, mos reago; largohu; thuaj «jo», kërko ndihmë, gjej një kompromis, etj.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuenca ①





DETYRA 7

RËNDËSIA E RREGULLAVE TË KLASËS DIZAJNIMI I KONTRATËS

Qëllimi

Nxënësit mendojnë për rëndësinë e rregullave dhe e dizajnojnë një kontratë të klasës.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Rregulla të ndryshme të prezantuara në tabelë apo letër
- ② Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; fletë të mëdha të letrës (p.sh. letër table)



Moduli 2

Sigurimi i cilësisë së jetës

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuenca ①

1. Mësimdhënësi i prezanton para nxënësve disa arsye për rëndësinë e rregullave (tabelë ose letër).
2. Nxënësit i qarkojnë ato me të cilat pajtohen. I krahasojnë me një shok klase.
3. Së bashku me partnerin mendojnë për rregullat të cilat do të donin t'i kenë në klasë. I shënojnë ato në një copë letre (një rregull në një copë letre). I vendosin letrat në tabelë.
4. Të gjithë nxënësit ulen në rreth dhe diskutojnë për rregullat të cilat do të donin t'i vendosin në kontratën e klasës. I diskutojnë arsyet e ndryshme për rregullat.
5. Për detyrë shtëpie nxënësit i shënojnë zgjedhjet e tyre për rregullat e klasës në fletë letre.

Sekuenca ②

1. Nxënësit ulen në rreth me rregullat e tyre individuale për rregullat e klasës. Në grup të madh diskutojnë cilat rregulla dëshirojnë t'i zgjedhin për kontratën e klasës. Pyetjet në vijim parashtrihen për secilin sugjerim të rregullave: A është kjo rregull e drejtë për të gjithë? A është kjo rregull e zbatueshme? A pajtohemi të gjithë për këtë rregull?
2. E gjithë klasa pajtohet së bashku me mësimdhënësin për dhjetë rregulla për kontratën e klasës.
3. Rregullat që zgjedhen shënohen nga mësimdhënësi në një fletë të madhe të letrës. Nxënësit i kopjojnë rregullat në fleta të letrës apo në fletoret e tyre të shkrimit.
4. Më pas të gjithë nxënësit nënshkruajnë në fund të kontratës së madhe të klasës.

**MATERIALET PËR NXËNËSIT**

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①**Rregulat e rëndësishme**

... të lejohet
nxënësi më i
dobët të fitojë

... të respektohen
secili në klasë
n class

... të jesh nxënësi
më i mire

... të lejohet secili
të marrë pjesë

... të bëhet klasa
rrëmujë

... të lejohet secili
të bëjë
çka dëshiron

... të jemi
të drejtë


... të krijojmë
atmosferë
të mirë

... të shmangen
konfliktet

... të jemi
të sjellshëm

... ta bësh
mësimdhënësin
t'i pëlqesh

... gjithmonë
të fitosh në lojë





DETYRA 8

RËNDËSIA E RREGULLAVE TË FAMILJES PUNA ËSHTË E VLEFSHME

Qëllimi

Nxënësit e bëjnë një hulumtim për rregullat më të rëndësishme në familjen e tyre. Ata reflektojnë mbi vlerën e punës.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Punë në grupe
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Tabela me rregullat e familjes në tabelë ose letër
- ② Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Tavolinat për grupe



Moduli 2

Sigurimi i cilësisë së jetës

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi i prezanton llojet e ndryshme të rregullave të cilat vlejné për jetën në familje.
2. Nxënësit e kopjojnë tabelën dhe i shënojnë rregullat që përdoren në familjen e tyre për secilën prej tyre.
3. Kur përfundojnë, i shkëmbejnë rregullat me partnerin. I diskutojnë këndvështrimet e tyre: Cilat rregulla e keni të vështirë t'i zbatoni? Pse? Përgjigjet në këto pyetje i shënojnë në kolonën e dytë.
4. Për detyrë shtëpie, nxënësit i pyesin anëtarët e familjes: Cilat rregulla mendon ai/ajo se janë të vështira për t'i zbatuar dhe pse? Këto i shënojnë në kolonën e tretë.

Sekuena ②

1. Nxënësit kthehen në rreth me rregullat e shënuara të familjeve së tyre.
2. Së bashku me mësimdhënësin i krahasojné rregullat. A ka rregulla të ngjashme? A janë rregullat të rëndësishme? Si kontribuojné rregullat në jetën familjare?
3. Pas kësaj, nxënësit formojné grupe nga 4 vetë. I diskutojnë 2–3 rregulla duke e përdorur pyetjen në vijim: Si i kontribuon kjo rregull jetës familjare? Nxënësit mbajnë shënime.
4. Më pas nxënësit kthehen në rreth. I prezantojnë idetë e tyre. Mësimdhënësi e drejton diskutimin për kontributin në jetën familjare dhe vlerësimin e punës që bëhet brenda dhe jashtë familjes.
5. Nëse mbetet kohë nxënësit mund të provojné t'i gjejné rregullat e veta, rregulla të reja në familjen e tyre. Këto mund t'i shënojnë në një fletë letre.



MATERIALET PËR NXËNËSIT


Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuenca ①

Rregullat e familjes

	Cila është rregulla?	Këndvështrimi yt	Këndvështrimi i familjes
Rregullat për shtëpinë (gatimi, pastrimi, etj.)			
Rregullat për trupin (pastrimi, tushi, etj.)			
Rregullat për sjellje (gjatë shujtave, në mbrëmje, etj.)			
Rregullat për lojë (shikimi i TV, loja jashtë, etj.)			
Rregullat për kohën (koha e gjumit, kur të kthehem në shtëpi, etj.)			





MODULI 3

STILET E JETËS SË SHËNDETSHME

Stilet e jetës së shëndetshme udhëzojnë nxënësit për çështjet që lidhen me shëndetin fizik dhe emocional, ushqimin e shëndetshëm, si kundërpërgjigje e veseve si droga, alkooli, duhanpirja, ndikimet gjinore, etj.



DETYRA 9

SHËNDETI IM ËSHTË I RËNDËSISHËM

Qëllimi

Nxënësit reflektojnë mbi stilin e tyre të jetës dhe njihen me piramidën e ushqimit.



Koha e nevojshme

45 minuta



Aranzimet sociale

- Punë individuale
- Diskutim plenar



Përgatitja

Definicioni për Shëndetin i dhënë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në tabelë



Moduli 3

Stilet e jetës së shëndetshme

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

1. Mësimdhënësi u jep mundësi nxënësve ta lexojnë definicionin për shëndetin të dhënë nga OBSH-ja.
2. Mësimdhënësi ua shpjegon nxënësve elementet e këtij definicioni.
3. Mësimdhënësi i shënon në tabelë fjalët kyçe në vijim afër njëra-tjetrës: gjumi, sporti, mëngjesi, pushimet, mirëqenia. Ai/ajo i diskuton këto koncepte.
4. Nxënësit i shënojnë përgjigjet e tyre në dërrasë të zeze (15 minuta): «gjumi»: Sa kohë ju duhet të flini gjatë natës në mënyrë që të jeni të pushueshëm? «sporti»: Sa lëvizni gjatë ditës? «mëngjesi»: A hani mëngjes dhe çka hani para shkollës? «pushimet»: A keni nevojë për pushim pas shkollës dhe si pushoni? Mirëqenia: Çka nënkupton kjo për nxënësit?
5. Mësimdhënësi diskuton me të gjithë nxënësit si dëshirojnë të përmirësohen. A dëshirojnë të merren më shumë me sport? A dëshirojnë të ushtrojnë në rreth për 5 minuta gjatë orës? Apo dëshirojnë të bëjnë sallatë për familjen në shtëpi? E kështu me radhë.
6. Për detyrë shtëpie nxënësit i hartojnë planet e tyre për përmirësim dhe mundohen tu përmbahen.
7. Pas dy javësh mësimdhënësi u kthehet ndryshimeve të stilit të jetës së nxënësve. Ai/ajo i motivon të vijnë me disa ide gjatë orës së ardhshme, si ushtrime të jogës/gjymnastikës në fillim të orës së ardhshme të udhëhequra nga ndonjë nxënës, sjellja e ndonjë recete të shëndetshme në orën e ardhshme apo prezantimi i mënyrës së tyre të pushimeve gjatë ditës. Përcjelli dhe ktheju ndryshimeve të nxënësve!



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Definicioni i «shëndetit» nga OBSH-ja:

«Shëndeti është gjendja e mirëqenies së plotë fizike, mentale dhe sociale e jo thjesht mungesa e sëmundjes apo dobësisimit fizik apo mental.»

Shpjegim: Shëndeti fizik nënkupton se personi ka gjum dhe ushtrime të mjaftueshme gjatë ditës dhe ushqehet shëndetshëm. Shëndeti mental është komponentë e shëndetit të përgjithshëm dhe e përshin mirëqenien dhe kënaqësinë. Mirëqenien nuk është lehtë ta definojmë pasi që përfshin aspekte individuale si mjedisi social, prosperiteti, vetë-njohja, cilësia e jetës dhe pjesëmarrja në shoqëri duke patur rol të rëndësishëm.



World Health
Organization



DETYRA 10 I SHËNDETSHËM GJATË GJITHË VITIT

Qëllimi

Nxënësit mësojnë për standardet e higjienës dhe ndikimin e stinëve në shëndet.



Koha e nevojshme

45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Letër, lapsa me ngjyrë; Gjashtë fjalët kyçe për higjienën në tabelë



Moduli 3

Stilet e jetës së shëndetshme

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

1. Mësimdhënësi e prezanton temën e higjienës dhe i shënon në tabelë gjashtë fjalët kyçe/temat që kanë të bëjnë me higjienën. Pastaj mësimdhënësi i udhëzon nxënësit të ndahen në grupe nga tre persona dhe të bisedojnë për njëri nga fjalët kyçe/temat. Çka dinë për atë fjalë kyçe/temë?
2. Pas 15 minutash, klasa mbledhet në rreth. Mësimdhënësi kërkon nga grupet ta prezantojnë temën e tyre para klasës. Secili grup ka rreth 3 minuta për prezantim. Mësimdhënësi mund të shtojë informata përderisa grupi prezanton. Pastaj nxënësit i vendosin fletat e tyre me rregullat e higjienës në mes të rrethit.
3. Pasi të prezantojnë të gjitha grupet, klasa duhet të votojë për pesë rregulla nga ato që janë prezantuar të cilat duhet të zbatohen nga e gjithë shkolla. Përveç kësaj, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të mendojnë nëse këto rregulla mund të ndryshojnë varësisht nga stina e vitit.
4. Mësimdhënësi i vendos në mur këshillat për higjienë dhe kontrollon cilat nga to zbatohen nga nxënësit.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Fjalët kyçe për higjienën

*duar
të pastra*

*roba
të pastra*

*higjiena
e dhëmbëve*



*higjiena
e trupit*

*higjiena
e ushqimit*

*pastërtia
në shtëpi*

Rregullat

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____
5. _____





DETYRA 11

TRUPI IM DHE SI NDRYSHON AI GJATË PUBERTETIT

Qëllimi

Nxënësit i kuptojnë ndryshimet nga fëmijë në të rritur. Reflektojnë për trupin e tyre dhe higjienën.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzimet sociale

- Punë në çifte
- Diskutim plenar
- Klasa e ndarë në djem dhe vajza



Përgatitja

- ① Fotografi të ndryshimeve në pubertet (nga interneti apo librat: ndryshimet në trupin e djemve dhe vajzave); grupi i vajzave: pecetat higjienike, tamponët; skenarët për pubertetin në fletë pune; copa të letrës
- ② Karriget në rreth të rreth për diskutim plenar



Moduli 3

Stilet e jetës së shëndetshme

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Luhet loja «ecja e pubertetit»: Të gjithë nxënësit shpërndahen nga njëri skaj i klasës (ose oborrit) në skajin tjetër. Mësimdhënësi fillon duke e prekur një nxënës në supe. Momentin që nxënësi e ndjen prekjen fillon të ecë drejt skajit tjetër të klasës. Ngadalë, mësimdhënësi i prek nxënësit njërin pas tjetrit në supe. Kah fundi mësimdhënësi sërish i prek ngadalë nxënësit në supe duke i lënë disa prapa dhe duke ecur i fundit kah skaji i klasës.
2. Nxënësit mblidhen në rreth. Mësimdhënësi parashtron pyetjet: Si u ndjeve pasi që ishe i pari që eci? I mesmi? I fundit? A ishte më mirë të ecni në grup? Ai/ajo e fillon diskutimin për ndryshimet në pubertet, duke theksuar se si në këtë lojë, disa fëmijë e fillojnë pubertetin më herët e disa më vonë.
3. Mësimdhënësi i shpjegon ndryshimet që ndodhin gjatë pubertetit në trupin e vajzave dhe djemve duke i përdorur fotografitë apo ilustrimet. Është me rëndësi që të mos detyrohen fëmijët të marrin pjesë patjetër në diskutim. Diskutimi mbetet i përgjithshëm përpos nëse parashtrihen pyetje nga nxënësit.
4. Pas diskutimin, klasa ndahet në djem dhe vajza. Mësimdhënësi punon me njerin grup, e grupi tjetër punon në mënyrë individuale për higjienën dhe shëndetin (detyre me shkrim).
5. Në grupet e tyre gjinore, nxënësit marrin copa të vogla të letrës. Mendojnë dhe i shënojnë pyetjet në to në mënyrë anonime. Mësimdhënësi i tërheq pyetjet një nga një dhe mundohet të përgjigjet. Për vajzat rekomandohet që sidomos tema e menstruacioneve të diskutohet (duke i treguar pecetat higjienike dhe tamponët). Për të dy grupet, adresohet edhe higjiena gjatë gjithë ditës. Për këtë rekomandohet forma e diskutimit të hapur.

Sekuena ②

1. Mësimdhënësi e vazhdon diskutimin për ndryshimet në pubertet. Tani nxënësit punojnë me skenarët në pubertet.
2. Nxënësit ndahen në çifte. Ata i marrin skenarët nga mësimdhënësi dhe i diskutojnë dy pyetjet dhe i shënojnë përgjigjet.
3. Kthehen në rreth dhe i ndajnë rezultatet e tyre. Mësimdhënësi e thekson se puberteti është proces të cilin secili e përjeton ndryshe dhe se kjo duket të respektohet. Praktika e higjienës mund të përsëritet edhe një herë këtu.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

Ndryshimet në pubertet



Pyetjet për diskutim të përgjithshëm:

Çka është puberteti?

Cilat janë ndryshimet kryesore në pubertet – në aspekt fizik dhe emocional?

Për djemtë? Për vajzat?

Si e mban trupin tënd të shëndetshëm?

Pse është higjiena e rëndësishme?

Grupet sipas gjinisë:

Detyrë me shkrim (për punë individuale)

Çka është e rëndësishme në pubertet?

Si e mban trupin tënd të shëndetshëm?

Pyetje të mundshme për diskutimin

Djemtë

- Kur të filloj të rruhem?
- Çka është ëndrra e lagët?
- A mund të përdor deodorant?
- A mund t'i shtrydhi puçrrat?
- ...

Vajzat

- Çka janë menstruacionet?
- Si të kujdesem?
- Kur mund të shminkohem?
- ...

Sekuena ②

Skenarët në pubertet

Julia është personi i fundit që zgjidhet për ekipe në sport. Ajo nuk është shumë sportive dhe është shumë e shkurtë. Nofka e saj është «Shkurte».


Alana është e gjatë, e madhe dhe kanë filluar t'i rriten gjinjët. Fëmijët nuk kanë dëshirë të rijnë afër saj për shkak të aromës së saj. Ajo djersitet shumë.

Tomë është djali më i vogël në klasë. Dy djem e kapën dhe e vendosën në shportën e mbeturinave.

Mariniti është rritur këmba për dy numra që nga vera. Si rezultat ai është i ngathët dhe fëmijët qeshin me të sa herë që merr në thua.

Livia çdo javë e ka nga një simpati tjetër. Ajo shminkohet dhe mban reçipeta në shkollë dhe gjithnjë flet për to. Ajo u dërgon djemve mesazhe. Livia u kërkon vajzave të tjera të shkojnë me të për të biseduar me djem.

Alexi është shumë i njohur dhe ka shumë miq. Së fundmi, vajzat kanë filluar t'i dërgojnë mesazhe dhe fotografi. Ato gjithnjë i pyesin shokët e Alexit nëse i pëlqejnë atij. Alexi i pëlqen basketbolli dhe nuk mendon për vajza në klasën e 5-të.





DETYRA 12

USHQIMI DHE TË USHQYERIT TË USHQYERIT E SHËNDETSHËM: PESË-NË-DITË

Qëllimi

Nxënësit reflektojnë për shprehitë e tyre të të ushqyerit dhe marrin ide për të ushqyer të shëndetshëm gjatë një dite.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Diskutim plenar



Përgatitja

Karriget në rreth për diskutim plenar;
Ushqime të vërteta apo fotografi të ushqimit; Etiketa me fjalë;
Shabllon për tabelë dhe detyra të shtëpisë në tabelë



Moduli 3

Stilet e jetës së shëndetshme

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Nxënësit ulen në rreth. Mësimdhënësi fillon diskutimin me pyetjen: «Çka është e shëndetshme dhe çka nuk është?» Ai/ajo nxjerr përgjigje si lëvizja, sporti dhe ushqimi i shëndetshëm si faktorë për të qëndruar të shëndetshëm. Pastaj ai/ajo i vendos disa lloje të ndryshme të ushqimit në një mbulesë në mes të rrethit (ose përdor fotografi). Mësimdhënësi i ka të përgatitura etiketat me fjalët: produkte të qumështit, pemë dhe perime, drithëra, mish/peshk/tofu (proteina), ushqime të ëmbla.
2. Nxënësit mundohen t'i klasifikojnë ushqimet në pesë kategoritë e ushqimit. Diskutojnë me mësimdhënësin për ushqimet e caktuara që janë të shëndetshme, ushqimet e caktuara që nuk janë të shëndetshme dhe ushqimet të cilat mund të hahen në sasi të vogla.
3. Më pas, e vizatojnë një tabelë dhe i shënojnë ushqimet në të.
4. Për detyrë shtëpie e bëjnë një hulumtim ku për tre ditë i shënojnë të gjitha ushqimet që familja e tyre i han gjatë asaj kohe.

Sekuena ②


1. Nxënësit kthehen me hulumtimin e tyre të tre ditëve. Ulen në rreth. Mësimdhënësi thekson se për një dietë të shëndetshme është e rëndësishme të përcillet rregulla e pesë-në-ditë, që nënkupton se çdo ditë duhet të hahen pesë porcione të pemëve dhe perimeve të ndryshme. (Që do të thotë pesë porcione të pemëve dhe perimeve në total, jo pesë porcione të secilës. Sipas OBSH-së një porcion i pemëve apo perimeve është 80 gr). Minimumi prej 40 gr të pemëve dhe perimeve në ditë e ul rrezikun prej sëmundjeve të zemrës, sulmit dhe disa lloje të kancerit.
2. Pastaj nxënësit i krahasojnë informatat nga hulumtimi i tyre tre ditësh. A ushqehen sipas rregullës pesë-në-ditë? Këndvështrimet e tyre i ndajnë në grup të madh.
3. Pjesën tjetër të orës nxënësit e dizajnojnë një tabelë javore për të mbajtur shënime për rezultatet e pesë-në-ditë. Mësimdhënësi u kërkon ta marrin në shtëpi, t'i tregojnë familjes për të, ta plotësojnë me sinqeritet dhe ta sjellin në sërish gjatë orës tjetër.
4. Mësimdhënësi mund tu ofrojë nxënësve një orë shtesë sporti ose lojërash si shtytje për tu bërë klasë pesë-në-ditë.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①



Të ushqyerit gjatë tre ditëve

	Mëngjesi	Dreka	Zamra	Darka
Dita 1				
Dita 2				
Dita 3				

Sekuena ②

Të ushqyerit gjatë javës

	Mëngjesi	Dreka	Darka
E hënë			
E martë			
...			



MODULI 4

DIZAJNIMI I KARRIERAVE PERSONALE DHE ZHVILLIMI I MENDËSISË NDËRMARRËSE

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse me theks në të kuptuarit e profesioneve nga perspektiva e tregut të punës, planifikimit të karrierës dhe vendimmarrjes për karrierë, ndërmarrësia si opsion i karrierës, etj.



DETYRA 13

ANËT E FORTA TË CILAT I DËSHIROJ JAM KAFSHË PËR NJË DITË

Qëllimi

Nxënësit reflektojnë për respektin që kanë për kafshët. Imagjinojnë se janë një kafshë për një ditë. Mësojnë si ta ndryshojnë këndvështrimin.

**Koha e nevojshme**

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta

**Aranzhimet sociale**

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar

**Përgatitja**

- ① Fotografi të kafshëve; Libra; Telefona të mençur
- ② Karriget në rreth për diskutim plenar; Letër, lapsa me ngjyrë

**Moduli 4**

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE**Sekuena ①**

1. Mësimdhënësi u tregon nxënësve fotografi të kafshëve të ndryshme (kafshë shtëpiake dhe të egra).
2. Nxënësit ulen në rreth dhe diskutojnë: Në çfarë mënyra janë kafshët të rëndësishme për ne? Mësimdhënësi i mbledh përgjigjet p.sh. ndihmë për punë, si shoqërues, për mbajtjen e balansit të ciklit të jetës (bletët, etj.).
3. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit ta zgjedhin një kafshë nga fotografitë. Ata e paramendojnë veten si të ishin ajo kafshë. Çka dinë për atë kafshë? Ku jeton? Në çfarë mënyra ka kontakt me njerëzit? A është e rrezikuar? Nxënësit kanë njëzet minuta për të menduar, hulumtuar dhe për të marrë shënime. Ata mund të hulumtojnë për pak kohë në libra, në internet, etj.
4. Pastaj, për 15 minuta, nxënësit lëvizin nëpër klasë dhe komunikojnë me njëri-tjetrin për rolet e tyre si kafshë.
5. Kthehen në rreth dhe diskutojnë si duhet të sillen njerëzit ndaj kafshëve. A kanë shembuj të njerëzve të cilët sillen keq me kafshët?
6. Për detyrë shtëpie, nxënësit mendojnë për kafshën që do ta zgjedhnin po të ishin kafshë për vetëm një ditë.

Sekuena ②

1. Nxënësit kthehen në rreth me kafshën të cilën e kanë zgjedhur.
2. Ata e prezantojnë kafshën e zgjedhur dhe i japin arsyet e tyre (p.sh. Dua të jem luan sepse luani është i fortë. Dua të jem mace sepse të gjithë i donë macet, etj.). Mësimdhënësi u jep ide për mbiemrat/karakteristikat që i përshkruajnë kafshët.
3. Pastaj nxënësit kthehen në vendet e tyre dhe shkruajnë një paragraf të shkurtër të kafshës që e kanë zgjedhur dhe arsyet e tyre.
4. Kur përfundojnë, nxënësit mund ta vizatojnë kafshën nën tekstit të tyre.
5. Fletat ekspozohen në klasë.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①





DETYRA 14

FOKUSOHEM NË ANËT E MIA TË FORTA PLANI IM PREJ PESË HAPASH

Qëllimi

Nxënësit reflektojnë për gjërat në të cilat mendojnë se janë të mirë. E bëjnë dallimin në mes të anëve të forta dhe potencialit për zhvillim.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Skica në tabelë; Letër
- ② Karriget në rreth për diskutim plenar



Moduli 4

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e vizaton një skicë të shkallëve në tabelë. Në shkallën e sipërme shënon «Jam i mirë në», në shkallën e mesme shënon «Do të isha i mirë nëse ushtrohem» dhe në shkallën e poshtme «Kurrë nuk do të jem i mirë në». Nëse ka mundësi mësimdhënësi mund t'i lejojë fëmijët që këtë ta bëjnë në shkallë të vërteta.
2. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të mendojnë për shkathtësitë e tyre dhe për gjërat që mund t'i bëjnë. Ata e kopjojnë skicën e shkallëve dhe i shënojnë idetë e tyre në secilën shkallë.
3. Pastaj, nxënësit e gjejnë një partner dhe i shkëmbejnë idetë për veten. Ata komentojnë për anët e forta, potencialin dhe dobësitë e njëri-tjetrit.
4. Për detyrë shtëpie, nxënësit mendojnë për potencialin e tyre dhe e dizajnojnë një plan prej pesë hapash për mënyrën se si mund ta përmirësojnë kompetencën/shkathtësinë e tyre. Mësimdhënësi e shpjegon planin prej pesë hapash, mundësisht duke ofruar ndonjë shembull.

Sekuena ②


1. Nxënësit vijnë në rreth me planet e tyre prej pesë hapash. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të bëhen nga dy dhe t'ia shpjegojnë planin njëri-tjetrit. Ata komentojnë në planet e njëri-tjetrit dhe i japin ide për ndihmë shtesë.
2. Pastaj, nxënësit reflektojnë gjatë dialogut me mësimdhënësin. Ata japin sugjerime si ta përcjellin planin e tyre (përkujtues, detyra, etj.).



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①





DETYRA 15

ANËT E FORTA TË GRUPIT TONË SHKATHTËSITË E KLASËS TONË

Qëllimi

Nxënësit mësojnë si ta bëjnë një studim dhe i identifikojnë shkathtësitë në të cilat janë të mirë në mënyrë individuale dhe si klasë.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Shablloni i studimit në tabelë ose letër
- ② Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Shablloni i grafikut në tabelë ose letër; lapsa me ngjyrë



Moduli 4

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi e vizaton një studim në tabelë (apo si kopje). Simbolet përdoren për shkathtësi të ndryshme.
2. Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit ta përdorin listën dhe të ecin nëpër klasë e ti pyesin të tjerët në çka janë të mirë. Nxënësit mundohen të pyesin sa më shumë veta në klasë.
3. Ata e bëjnë nga një shenjë çdo herë që dikush përgjigjet. Nga secili person kërkojnë që të japë ndonjë shembull.
4. Në fund, edhe ata e shënojnë në çka janë të mirë. Pastaj i mbledhin përgjigjet për secilën shkathtësi që është përmendur dhe i plotësojnë.
5. Kthehen në rreth dhe i shkëmbejnë rezultatet.

Sekuena ②

1. Në orën e radhës, nxënësit i marrin numrat nga tabelat e tyre dhe së bashku me mësimdhënësin i shënojnë ato në një grafik.
2. Kolonat i ngjyrosin me ngjyra të ndryshme.
3. Kthehen në rreth sërish dhe reflektojnë për shkathtësitë e klasës së bashku me mësimdhënësin. Së bashku i diskutojnë disa shembuj. Gjithashtu diskutojnë pse është e rëndësishme të kenë disa shkathtësi si grup.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①



Të menduar, zgjidhje e problemeve



Rregullimi i gjërave



Komunikim me njerëz sy më sy



Këndim, vallëzim, luaj instrument



Ngjyrosje, vizatim



Punë me numra



Organizimi i gjërave



Ndihmë tjerëve



Tregimi i tregimeve

Ne jemi të mire në shumë gjëra

Shkathësia	Shembull	Tik	Nr.
Të menduar, zgjidhje e problemeve			4
Rregullimi i gjërave		 	6
Komunikim me njerëz sy më sy			

Sekuena ②

Shkathësitë e klasës tonë

Shkathësia	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Të menduar, zgjidhje e problemeve										
Rregullimi i gjërave										
Komunikim me njerëz sy më sy										



DETYRA 16

PËRSHTYPJET E PARA JANË TË RËNDËSISHME UNË E PREZANTOJ VETEN

Qëllimi

Nxënësit mësojnë ta prezantojnë veten dhe tu japin të tjerëve informata kthyesë.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Fjalët kyçe në tabelë apo në letër; Letër A5 ose A4
- ② Karriget në rreth për diskutim plenar; Copa të vogla të letrës për informata kthyesë



Moduli 4

Dizajnimi i karrierave personale dhe zhvillimi i mendësisë ndërmarrëse

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi përgatit disa fjalë kyçe në tabelë ose në letër.
2. Mësimdhënësi u jep nxënësve detyrë të mendojnë se si do ta prezantonin veten, p.sh. për një punë të vogël gjatë kohës së tyre të lirë (kujdestare për fëmijë, ndihmë në punë, etj.)
3. Mësimdhënësi bisedon për gjërat e rëndësishme gjatë prezantimit. Ai/ajo i mbledh idetë e nxënësve (p.sh. çka të prezantohet, fjali të qarta, zë i lartë, ndihmesat vizuale, kontakti me sy, etj.)
4. Nxënësit e dizajnojnë një prezantim të vetes. Për këtë mund të përdorin fleta të letrës, mu sikur sillajdet në prezantim me Power Point. Në secilën fletë shkruajnë nga disa fjalë apo vizatojnë diçka. Mund të përdorin më së shumti gjashtë fletë.
5. I shkëmbejnë idetë dhe i provojnë prezantimet me një shok. Nëse ka nevojë mund të bëjnë adaptime.
6. Për detyrë shtëpie nxënësit i praktikojnë prezantimet e tyre.

Sekuena ②

1. Në orën e radhën nxënësit vijnë me fletët e tyre dhe përgatiten për prezantim. Shokët e tyre i dëgjojnë dhe pas çdo prezantimi japin informatë kthyesë. Ata shënojnë një gjë pozitive dhe një fushë për përmirësim. Mësimdhënësi sigurohet që informata kthyesë jepet në mënyrë konkrete, konstruktive dhe me respekt.
2. Pasi të përfundojnë prezantimet, mësimdhënësi reflekton së bashku me nxënësit për atë se si u ndjenë kur e prezantuan veten.
3. Po të kishe mundësi, në cilin vend pune do të aplikojë? Diskutoni së bashku.





MATERIALET PËR NXËNËSIT


Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ②

Ky/kjo jam unë
Po ua prezantoj veten




Për mua



Interesat e mi



- _____
- _____
- _____

Familja ime



Anët e mia të forta

- _____
- _____
- _____





MODULI 5

SIGURIA PERSONALE

Siguria personale i pajis nxënësit me qëndrim të orientuar kah sjellja që mundëson sigurinë personale dhe të tjerëve.



DETYRA 17

FËMIJËT KANË TË DREJTË TË JENË TË MBROJTUR DHE TË SIGURT

Qëllimi

Nxënësit reflektojnë për rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të fëmijëve.

**Koha e nevojshme**

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta

**Aranzhimet sociale**

- Punë individuale
- Punë në çifte
- 2 grupe të mëdha
- Diskutim plenar

**Përgatitja**

- ① Ilustrimet në tabelë; Fotografii; Etiketat me të drejtat e fëmijëve; Letër, lapsa me ngjyrë
- ② Karriget në rreth për diskutim plenar

**Moduli 5**

Siguria personale

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE**Sekuena ①**

1. Mësimdhënësi i vizaton dy fëmijë në tabelë. Shtohen flluskat për tekst. Njëri fëmijë thotë: «Unë punoj në fabrikë», tjetri thotë: «Unë nuk ngrënë qe sa ditë». Mësimdhënësi e tregon secilin vizatim dhe pyet: «A është ky fëmijë i mbrojtur dhe i sigurt?». Ai/ajo i inkurajon nxënësit të japin arsye pse.
2. Mësimdhënësi e shpjegon kuptimin e të qenit i sigurt dhe jo i sigurt dhe i shënon dy fjali në tabelë: «Fëmijët janë të sigurt dhe të mbrojtur». «Fëmijët nuk janë të sigurt dhe të mbrojtur.» Bëhet stuhi mendimesh për të mbledhur sa më shumë situata për të dy kolonat. Mësimdhënësi e thekson se ekziston «Deklarata për të Drejtat e Fëmijëve (1959)» dhe «Dita Ndërkombëtare e Fëmijës» (më 20 nëntor)
3. Mësimdhënësi e ndan klasën në dy grupe dhe ua shpërndan etiketat me të drejtat e fëmijëve dhe disa fotografi nga revistat që paraqesin situata të sigurta dhe të pasigurta (duke u kujdesur, duke u ngushëlluar, duke u kujdesur kur je i sëmurë, duke u ngacmuar, dhunë, etj.)
4. Nxënësit i shikojnë fotografitë dhe i klasifikojnë në «të sigurta» dhe «të pasigurta». Mësojnë si t'i dallojnë situatat në të cilat fëmijët duhet të mbrohen dhe situatat ku kjo nuk ndodh por do të duhej.
5. Mësimdhënësi i ndihmon të dy grupet dhe e kontrollon klasifikimin.
6. Të gjithë nxënësit i shënojnë rastet «sigurt/pasigurt» në dy kolonat.

Sekuena ②

1. Nxënësit kthehen në rreth. Mësimdhënësi i rishikon edhe një herë dallimet në situatat sigurt dhe pasigurt apo mbrojtur dhe pambrojtur.
2. Nxënësit punojnë në mënyrë individuale dhe mendojnë për një situatë ku ata janë ndier të mbrojtur dhe të sigurt dhe një situatë ku janë ndier të pambrojtur dhe të pasigurt.
3. Mësimdhënësi u jep nxënësve nga dy fleta A4 ku ata e shënojnë nga një paragraf të shkurtër dhe bëjnë nga një vizatim.
4. Kur përfundojnë me të dy fletat, i shkëmbejnë me një partner.
5. Mësimdhënësi vendos në bazë të dinamikës së grupit nëse vazhdohet me diskutim të përbashkët.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuënca ①

Etiketat me të drejtat e fëmijëve



living-democracy.com/childrens-rights-cards, Ilustrimi: Peti Wiskemann



DETYRA 18

SITUATAT E RREZIKSHME ÇKA TË BËJ?

Qëllimi

Nxënësit mësojnë për situata të ndryshme të rrezikshme dhe zhvillojnë strategji si të veprojnë.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzimet sociale

- Punë individuale
- Punë në çifte
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Karriget në rreth për diskutim plenar; Fotografi të situatave të rrezikshme; Copa të vogla të letrës
- ② Telefona mobil; Poster me numrat emergjent; Poster me pyetjet kryesore



Moduli 5

Siguria personale

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Nxënësit ulen në rreth. Mësimdhënësi e prezanton temën duke e vendosur në mes të rrethit një fotografi (apo disa fotografi) të situatave të rrezikshme (p.sh. zjarri, aksident, vjedhje, etj.)
2. Mësimdhënësi e fillon diskutimin për situatat e ndryshme që mund të jenë të rrezikshme (në shtëpi, në shkollën, në rrugë etj.). Nxënësit i shkëmbejnë mendimet e tyre. Mësimdhënësi mban shënime (në copa të vogla të letrës) dhe i vendos në mes të rrethit.
3. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të ndahen në çifte. Secili çift mund ta zgjedh një situatë. Secili çift mendon çka duhet të bëjnë në secilën situatë. Marrin shënime dhe përgatiten për një prezantim të shkurtër.
4. Nxënësit kthehen në rreth dhe i prezantojnë idetë e tyre. Mësimdhënësi nxjerr strategji si kërkesa për ndihmë, thirrja e numrave të emergjencës të policisë, ambulancës apo zjarrfikësve, ndihmë nga një i rritur, bisedë me mësimdhënësin, etj., varësisht nga situata.

Sekuena ②

1. Në orën e radhës, nxënësit ulen sërish në rreth. Mësimdhënësi i përsërit situatat e ndryshme të rrezikshme dhe i thekson institucionet e ndryshme që mund të kontaktohen në rast të zjarrit, emergjencës shëndetësore apo rreziqeve të sigurisë/krimin. Mësimdhënësi mund t'i pyes nxënësit nëse kanë qenë ndonjëherë në situatë të tillë. Numri i policisë, zjarrfikësve dhe ambulancës shënohen me shkronja të mëdha në një poster. Posterit vendoset në klasë.
2. Nga nxënësit kërkohet të t'i dramatizojnë këto situata të rrezikshme në lojë me role. Sërish, çiftet e njëjta (nga sekuena 1) punojnë së bashku për situatat e tyre. Mësimdhënësi i diskuton me nxënësit çështjet kryesore dhe përgjigjet që duhet t'i mbajnë mend kur i thërrasin numrat emergjent: «Kush» thërret? «Çka» ka ndodhur? «Kur» ka ndodhur? «Kush» është i përfshirë/lënduar etj.? «Ku» gjendet?
3. Çiftet e praktikojnë lojën e tyre me role.
4. Disa cifte e prezantojnë lojën e tyre me role para te tjeve.
5. Posterit final me pyetjet kryesore dhe informatat kyçe që duhet tu jepën shërbimeve emergjente ekspozohet në klasë.




MATERIALET PËR NXËNËSIT


Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune


Sekuena ②

Veprimi në rast rreziku

Numrat emergjent

???





Çka të bëj?


KUSH po thërret?

ÇKA ka ndodhur?

KUR ka ndodhur?

KUSH është përfshirë/
lënduar, etj?

KU gjendet?





DETYRA 19

TË JESH I SIGURT NË RRUGË

Qëllimi

Nxënësit mësojnë si ta bëjnë një studim. I identifikojnë rreziqet në rrugë në mjedisin e tyre përreth shkollës dhe në rrugë. Zhvillojnë sjellje të duhur në trafik dhe mësojnë si të jenë të sigurt.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë në çifte
- Punë në grupe
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Skica e hartës së rrethinës së shkollës; Pyetjet për studim në etiketa apo në tabelë; Shablloni i grafikut në tabelë
- ② Karriget në rreth për diskutim në grup të madh



Moduli 5

Siguria personale

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuena ①

1. Mësimdhënësi u tregon një skicë të thjeshtë të rrugëve përreth shkollës. Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit të tregojnë nga cili drejtim vijnë në shkollë dhe ku e kalojnë rrugën. Nxënësit e shënojnë rrugën për në shkollë me lapsa me ngjyrë.
2. Mësimdhënësi u tregon nxënësve se do ta bëjnë një studim për sigurinë në rrugë. Nxënësit ndahen në çifte. Mësimdhënësi u shpërndan nga një pyetje për secilin çift.
3. Nxënësit e bëjnë studimin dhe kthehen në rreth.
4. Mësimdhënësi i mbledh përgjigjet dhe i shënon në tabelë.
5. Diskutojnë për studimin. Si janë përgjigjur shumica? Ku gjenden rreziqet më të mëdha? Ku e kanë shoferët më së vështiri për t'ju parë? Çka mund të bëjnë shoferët për t'ju mbrojtur?
6. Për detyrë shtëpie, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit ta dizajnojnë një fletëpalosje për nxënësit (e rinj) për mënyrat se si të jemi të sigurt në rrugë. Fletëpalosjen mund ta dizajnojnë si të kenë dëshirë, por duhet t'i përmbajë së paku pesë rregulla për sjellje të sigurt. Mësimdhënësi mund të japë disa shembuj.

Sekuena ②

1. Në orën e radhës, nxënësit i sjellin fletëpalosjet e tyre dhe i ekspozojnë në klasë.
2. Të gjithë nxënësit ecin nëpër klasë dhe i shikojnë fletëpalosjet si të ishin në ndonjë ekspozitë.
3. Pastaj e formojnë rrethin me fletëpalosjet e tyre dhe japin shembuj të rregullave të veta. Mësimdhënësi i mbledh shembujt.
4. Në vijim, dalin jashtë dhe i praktikojnë sjelljet e sigurta në rrugë së bashku me fletëpalosjet e tyre. Varësisht nga numri i nxënësve, mësimdhënësi mund t'i ndajë nxënësit në grupe më të vogla nga katër persona për ta praktikuar sjelljen e sigurt dhe për t'i dhënë njëri tjetrit informata kthyesë.
5. Më pas, kthehen në klasë dhe diskutojnë në rreth nëse rregullat e tyre ishin të zbatueshme dhe nëse iu kanë përmbajtur.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuensa ①



Pyetjet për studim



A mendon se rrugët në lagjen tuaj janë të rrezikshme për fëmijët që ecin apo shëtisin me biçikletë?

Kur ecni apo jeni me biçikletë, a brengoseni se ndokush mund të ju shkelë me veturë?

A ju ka shkelur ndonjë herë ndonjë veturë apo keni qenë në rrezik të ju shkelë kur keni qenë duke ecur ose me biçikletë?

A mendoni se veturat ndonjëherë shkojnë shumë shpejt në rrugët e lagjes tuaj?

A mendoni se rruga nga shtëpia juaj deri në shkollë mund të bëhet më e sigurtë për fëmijët që ecin apo janë me biçikletë?

A mendon se do të ecje apo do ta ngasje biçikletën më shumë nëse lagja jote do të ishte më e sigurt?

A do të doje të ecje apo ngasje biçikletën më shumë, për shembull për në shkollë, në park apo për tu takuar me miq?

A mendon se lagja jote ka nevojë për më shumë trotuare, shtigje dhe zebra për të ecur deri në park apo shitore, për t'i takuar miqtë apo për të shkuar në shkollë?

A ke qenë ndonjë herë në veturë me ndonjë shofer i cili mendon se e ka ngasur veturën shumë shpejt?

A ke qenë ndonjëherë në veturë me ndonjë shofer i cili ka folur apo shkuar mesazhe në telefon?

A ke parë ndonjëherë në lagjen tënde shoferë duke përdorur telefonin?

A ke qenë ndonjëherë në veturë me ndonjë shofer i cili ka folur ose shkruar mesazhe në telefon?

Po

||||

Jo

||||



DETYRA 20

TË JESH I SIGURT NË SHTËPI DHE NË SHKOLLË

Qëllimi

Nxënësit mbledhin situata të rrezikshme në shtëpi dhe shkollë dhe zhvillojnë përgjigje të adekuata në rast të emergjencës.



Koha e nevojshme

- ① 45 minuta
- ② 45 minuta



Aranzhimet sociale

- Punë individuale
- Punë në grupe
- Diskutim plenar



Përgatitja

- ① Fotografi të situatave të rrezikshme në shtëpi dhe shkollë; Etiketa të vogla, fleta të mëdha, lapsa me ngjyra
- ② Karriget në rreth për diskutim në grup të madh; Posterë grupor nga sekuenca 1



Moduli 5

Siguria personale

PËRSHKRIMI I ORËS MËSIMORE

Sekuenca ①

1. Mësimdhënësi e fillon orën me lojën «Zjarr, ujë, vetëtimë»: Nxënësit lëvizin përreth sipas muzikës. Kur ndërpritet muzika, mësimdhënësi e thotë një fjalë: «zjarr», «ujë» apo «vetëtimë». Zjarr: të gjithë nxënësit hipin mbi karrige apo ulen në tavolinë (këmbët nuk duhet t'i kenë në dysheme). Ujë: të gjithë nxënësit shtrihen në dysheme dhe bëhen sikur po notojnë. Vetëtimë: të gjithë nxënësit ndalen dhe shtangohen sikur të jenë të prekur nga vetëtimja.
2. Më pas të gjithë mblidhen në rreth. Mësimdhënësi flet për situatat e rrezikshme, në shtëpi dhe në shkollë. Nxënësit i mbledhin situatat e rrezikshme. Mësimdhënësi i shënon ato në copa të vogla të letrës dhe i vendos ato në rreth.
3. Mësimdhënësi zgjedh situata të ndryshme me të cilat do të punojnë nxënësit. Ata ndahen në grupe nga katër persona (kështu që numri i situatave duhet t'i përshtatet numrit të grupeve). Secili grup do të punojë në një situatë.
4. Në grupe diskutojnë se çka duhet të bëjnë në atë situatë dhe e shënojnë. Pastaj e bëjnë një poster me rekomandimet e tyre. Mësimdhënësi lëviz nëpër klasë dhe u ndihmon grupeve.

Sekuenca ②

1. Nxënësit i prezantojnë posterët e tyre. Gjithnjë dy nxënës qëndrojnë para posterit, ndërsa gjysma tjetër e klasës lëviz përreth. Dy «ekspertët» e shpjegojnë posterin dhe përgjigjen në pyetje.
2. Pas kësaj, gjysma tjetër e ka radhën t'i shikojë posterët e ndryshëm, ndërsa dy nxënësit që tashmë kanë shëtitur qëndrojnë para posterit dhe e shpjegojnë e përgjigjen në pyetje.
3. Kur perfundon prezantimi i postereve, ulen në rreth dhe flasin për përvorjet. Mësimdhënësi e permblodh diskutimin me loje me role.
4. Nxënësit duhet ta imagjinojnë se janë në situatë emergjente. Imithohet telefonata emergjente. Nxënësit, së bashku me mësimdhënësin vendosin për një situatë (psh aktident në shkollë, zjarr në shtëpi, etj). Njëri nxënës e luan rolin e personit që telefonon, tjetri të personit që përgjigjet. Mësimdhënësi i thekson informatat të cilat duhet t'i ofrojë ai që thërret: Çka? Kur? Ku? Kush? Telefonata emergjente praktikohet disa herë me nxënës të ndryshëm dhe situata të ndryshme.



MATERIALET PËR NXËNËSIT

Në dërrasë të zezë/projektor/fletë pune

Sekuena ①

